



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 219, Datë 11.10.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “DON – UCD” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “DON – UCD” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 212, datë 27.09.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “DON-UCD” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën me nr. 55/59 Prot., datë 28.09.2018, ka bërë njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me këtë aplikim.
- Po ashtu me shkresën nr. 592/1 Prot., datë 28.09.2018, ERE ka përcjellë pranë subjektit njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës si dhe kërkesën për plotësim dokumentacioni e cila kishte të bënte me strukturën e ndërtimit të shoqërisë (neni 9, pika 2, gërma “e”) i Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike
- Sa më sipër, shoqëria “DON – UCD” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 592/2, datë 04.10.2018, ka plotësuar dokumentacionin e munguar në aplikimin e tij.
- Aplikimi i shoqërisë “DON - UCD” shpk, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “DON - UCD” shpk, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5(pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**